Në Teatrin Komedia sonte (27 dhjetor) do të luhet premiera e shfaqjes „Nuk do të paguaj“ nga Dario Fo, në regji të Aleksandra Kardalevskës...



Skenografinë e ka bërë Zoran Gjurevski, ndërsa kostumografia është e Maja Gjurevskës dhe Antonina Gurinska – Jordanoska. Përzgjedhjen e muzikës e ka bërë Aleksandar Jordanovi, ndërsa dramaturg është Darko Jan Spasov.

Në premierën e fundit të IK Teatri Komedia Shkup, për këtë vit luajnë: Atanas Atanasovski, Valentin Kostadinovski-Tino, Zorica Nusheva, Zhaklina Petrovska dhe Aleksandar Mihajllovski. Satira politike „Nuk do të paguaj“, nga fituesi i shpërblimit Nobel për letërsi, shkrimtarit italian të dramës, skenaristi, regjisori, aktori dhe luftëtari për të drejtat dhe barazinë e njeriut Dario Fo, i pasqyron reagimet e konsumatorëve kundër rritjes së çmimeve dhe është reagim provokues kundër keqpërdorimeve dhe padrejtësisë në shoqëri.

Me këtë premierë, IK Teatri “Komedia” e realizoi në tërësi programin e punës për vitin 2018.